



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:083005

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05470826

KF.nr.79/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në kontestin tregtar administrativ, të paditësit N.T.P. Leka Med, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.A. Avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, me objekt kontesti - anulim vendimi e vlerësim tatimor, vlerë kontesti a pa përcaktuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësueses së autorizuar të paditësit Avokat E.A., dhe në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të paditurit, me datë 14.03.2024 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.T.P. Leka Med, me seli në Prishtinë.
- II. ANULOHET PJESËRISHT vendimi i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr.591/2019 i datës 13.02.2020, dhe atë mbi shumen prej 8.330.15€.
- III. MBETËT NË FUQI Vendimi i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr.591/2019 i datës 13.02.2020, në pjesës tani më jo kontestuese dhe atë për shumen e caktuar si detyrim prej 8.330.15 €, sipas raportit të Kontrollit të datës 15.05.2015, të Administratës Tatimore të Kosovës, dhe njoftim vlerësimeve nga e paditura.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A R S Y E T I M

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër vendimit nr.591/2019 të datës 13.02.2020. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor – kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse deklaroi se: nisur nga një gjendje e tillë e çështjes dhe duke u bazuar në mendimin e eksperteve paditësi dhe i autorizuar i tyre nuk kanë vërejtje në

mendimin e grupit të eksperteve dhe nuk kanë ndonjë pyetje me arsyetim se të gjitha faktet që janë me rendësi janë arsyetuar me mendimin e tyre. Ne pajtim me mendimin e grupit të eksperteve bëjmë precizimin e kërkesë padisë dhe i propozojmë gjykatës ashtu që: të miratohet kërkesë padia e paditësit NTP “ Meka Led ” me seli në Prishtinë si e bazuar dhe vendimi i të paditurës ATK-ë, nr.591/2019 i datës 13.02.2020, të anulohet pjesërisht dhe atë mbi shumën prej 8.330.15 €, derisa të mbete në fuqi vendimi nr.591/2019 i datës 13.02.2020, për shumën e caktuar si detyrim prej 8.330.15 €, përfshirë ndëshkimin si shumë tanimë jo kontestuese në këtë lëndë, nga të gjitha provat të cilat u shqyrtuan gjatë procedurës së administrimit të provave, e posaçërisht me ekspertizën financiare të grupit të eksperteve u vërtetua bindshëm se vendimi kontestues i të paditurës mbi shumën e detyrimit të paditësit siç u precizua me lartë është jo ligjor dhe si i tillë duhet të anulohet në këtë pjesë. Paditësi nuk e konteston shumën prej 8.330.15 €, përfshirë ndëshkimet si detyrim ndaj të paditurës. Shpenzimet e procedurës i kërkoj dhe atë në shumë të përgjithshme prej 5.000.00 €. Shpenzimet e procedurës i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në padi të paditësit N.T.P. Leka Med , si të pa bazuar në ligj dhe fakte materiale, duke vlerësuar se vendimi i kontestuar i DA të ATK-së, ka mbështetje ligjore dhe faktike si në shkresat e lëndës dhe është në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor – kryesor përfaqësuesi i autorizuar i palës së paditur nuk prezanton ndonjësi i njëjti është ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa me parashtresat e datës 06.03.2024 dhe 14.03.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë duke kërkuar nga gjykata që të veproni në bazë të nenit 38 paragraf 5 të LKA-së. Shpenzimet e procedurës i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, ka administruar provat relevante dhe atë: vendimi 591/2019 i datës 13.02.2020, aktgjykim A.nr.1665/15 i datës 03.12.2019, përgjigja në padi e datës 08.11.2021, 02.08.2018, pasqyre e tatim paguesit e datës 02.01.2024, ankesa e ushtruar në ATK e datës 22.06.2015, vendimi 222/2015 i datës 10.08.2015, raporti i kontrollit i datës 15.05.2015, stoku i mallit i datës 11.11.2013, 31.12.2008, kartela e kontos 5610 e datës 22.06.2015, 5540/08.07.2015, shpenzimet operative për vitin 2007, 2008, flet kalimi – kalkulimi nr12300046 datës 30.12.2008, libri i blerjes për vitin 2008, planet e amortizimit të kredisë, pasqyra bankare në PCB për periudhën 01.01.2005-31.12.2006 dhe 01.01.2006-31.12.2011, në Raiffaisen Bank për periudhën 31.01.2008-31.12.2008, në Bankën për biznes për periudhën 01.01.2010-22.12.2012, dhe 01.06.2009-19.12.2009, 01.01.2009-31.12.2009, pasqyrat e

mbitërheqjes ne Raiffaisen Bank, ekspertiza financiare e eksperti R.B. e datës 28.06.2022, ekspertiza financiare e eksperti financiar SH.B. e datës 31.10.2023, pasqyre e llogaris ne truste për periudhën 01.08.2022-09.10.2023, dhe super ekspertiza financiare e datës 05.02.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë Kontest Tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë Kontest Tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, Raportit të kontrollit të dt:15.05.2015, deklarimeve në padi dhe përgjigje në padi, shkresave të lëndës, vendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti subjekti, Leka Med, me seli në Prishtinë, nga e paditura ATK-ë i është nënshtruar kontrollit ku objekt i kontrollit kanë qenë periudhat tatimore për TVSH-ë 01/2008-12/2013, CD për vitet 2007 – 2012, dhe CM 01/2008 – 12/2013, e ku nga ky kontroll ka pasur ndryshime, dhe atë sikurse në faqen 4 të raportit të kontrollit, respektivisht tek rezultatet e kontrollit. Po ashtu, nuk është kontestuese as fakti se subjekti në procedurë ka ushtruar ankesë pranë Departamenti të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, e cila me fillimisht me datën 10.08.2015 ka marrë vendimin nr.222/2015, me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën në procedurë administrative, pastaj në rivendosje sipas aktgjykimit A. nr.1665/15 të datës 03.12.2019 edhe vendimin refuzues tani kontestues 591/2019 të datës 13.02.2020, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar ankesën e subjektit tatimor, e kundër të cilit paditësi me këtë padi ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, gjykata ka konstatuar se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës – Departamenti i Ankesave në shkallë të dytë e ka refuzuar ankesën e subjektit tatimor këtu paditësit, me arsyetim se vlerësimi zyrtar nga ana e ATK-së është bërë komfor Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe nenit 132/2 të Ligjit nr. 05/L-031. Tutje ka theksuar se Divizioni i Ankesave pas analizimit të shkresave në lëndë, vendimit të divizionit të ankesave nr. 222/2015 të datës 10.08.2015, vlerësimit të kontrollit si

dhe provave tjera materiale vendos që tatimpaguesi këtu paditësi do të mbetet obligues sipas vendimit nr. 222/2015 të datës 10.08.2015.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin financiar R.B., pastaj edhe ekspertizë tjetër me ekspertin financiar SH.B. me detyrat përkatëse sikurse në aktvendimet e gjykatës.

Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra të ekspertëve financiar në ekspertizat financiare të datës 28.06.2022 të ekspertit financiar R.B. dhe 31.10.2023 të ekspertit financiar SH.B., dhe sqarimeve të paraqitura edhe në shqyrtimet gjyqësore nga ana e këtyre ekspertëve financiar për detyrat e caktuara për ekspertizë janë dhënë mendime dhe vlerësime të ndryshme, për tatimin shtesë që është paguar dhe për atë që mbetet obligues këtu paditësi, për llojet e tatimit, TVSH-ë, CD dhe CM për periudhën kontestuese.

Vlerësimet faktike dhe juridike lidhur me pikën I, dhe II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Gjykata, sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.79/22 të datës 08.11.2023 ka caktuar grupin prej 3 ekspertëve financiar dhe atë: ekspertët financiar V.I., SH.J. dhe R.S. në këtë kontest tregtar administrativ, me detyrat përkatëse si në dispozitiv të këtij aktvendimi, të cilët kanë nxjerrë ekspertizën e datës 05.02.2024, në të cilën është dhënë mendimi dhe konstatimi se: *“grupi i ekspertëve gjatë analizës gjithëpërfshirëse të shkresave të lëndës dhe informatave të siguruar në procedurë të ekspertimit konstaton se raporti i kontrollit të ATK-së, si dhe vendimi kontestues i DA-së nuk kanë konstatuar saktë detyrimet tatimore të tatimpaguesit këtu paditësit. Tutje detyrimet tatimore dhe ndëshkimet 25% të aplikuara sipas raportit të kontrollit të ATK-së, që janë rishikuar pjesërisht me vendimin kontestues të DA-së dhe sipas grupit të ekspertëve është si vijon, totali sipas ATK-së 152,823.90 euro me ndëshkim 25%, totali sipas grupit të ekspertëve është 8,330.15 euro me ndëshkim 25% dhe diferencat që duhet të zbriten në total janë 144,493.75 euro me ndëshkim 25%.*

E paditura me parashtrësat e datës 06.03.2024 dhe 14.03.2024 ka paraqitur kundërshtimin lidhur me ekspertizës financiare të punuar nga grupi i ekspertëve financiar.

Eksperti financiar V.I., në emër të grupit të ekspertëve në seancën e datës 14.03.2024, ka theksuar se: *“në emër të grupit të eksperteve mbetem në tersi prapa mendimit dhe konstatimit të dhënë si në super ekspertizën e hartuar të datës 05.02.2024. lidhur me parashtrësat e pranuar nga pala e paditur e të cilat janë kundërshtim i super ekspertizës financiare, për te njëjtat nuk kam se çka të shtojë me shume për veç atyre të cilat i kemi theksuar në super ekspertizë”*.

Gjykata e ka pranuar super ekspertizën financiare të datës 05.02.2024, të punuar nga grupi i ekspertëve financiar V.I., SH.J. dhe R.S. në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat.

Gjykata përfundimisht, bazuar në provat e administruara dhe në super ekspertizën financiare të datës 05.02.2024 ka ardhur deri tek konstatimi se qarkullimi shtesë më tepër i ngarkuar nga e paditura me raportin e kontrollit të datës 15.05.2015, dhe i ndryshuar pjesërisht me vendimin 222/2015 të datës 10.08.2015, i vërtetuar si i tillë edhe me vendimin tani më kontestues në këtë lëndë 591/2019 të datës 13.02.2020, ka përlllogaritur më tepër sa sa realisht është dashur tatim shtesë referuar Tatimit mbi vlerën e shtuar - TVSH-së, tatimit në të ardhura individuale duke aplikuar edhe ndëshkim prej 25%, si për tatimin shtesë ashtu edhe për zbritjen e kreditimit.

Ndryshimet ndërmjet asaj se çka është konstatuar si qarkullim shtesë nga e paditura nga e cila ka rrjedh edhe tatimi shtesë dhe asaj se çka është konstatuar nga grupi i eksperteve financiar në super ekspertizën financiare të datës 05.02.2024, është paraqitur në formë tabelore, në mënyrë të specifikuar, në super ekspertizës financiare si më lartë dhe atë në faqet 19 dhe 20 të saj, referuar mendimit dhe konstatimit të dhënë nga grupi i ekspertëve financiar.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit është plotësisht i bazuar dhe i drejtë dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për llojet e tatimeve për periudhën kontestuese 2008 - 2013.

Paditësi qysh në fazën e kontrollit por edhe gjatë fazës së ankimimit tek e paditura në procedurë administrative ka paraqitur librat kontabël, stokun, shpenzimet operative, kreditë bankare dhe planet e amortizimit të tyre si dhe të dhënat e llogarive bankare dhe mbi këtë bazë edhe ka dëshmuar pretendimet e veta, fakt ky i konstatuar edhe me super ekspertizë financiare, mirëpo e paditura nuk i ka marrë për bazë këto dokumente dhe pa një konstatim të saktë të gjendjes faktike dhe elaborim të tërësishëm të bazës ligjore ka ardhur deri tek vendimi kontestues.

Pala paditësi në seancë shqyrtimit gjyqësor kryesor ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar vetëm : te miratohet kërkesë padia e paditësit NTP “ Meka Led ” me seli ne Prishtine si e bazuar dhe vendimi i te paditurës ATK-ës , nr.591/2019 i datës 13.02.2020, te anulohet pjesërisht dhe atë mbi shumën prej 8.330.15 €, dhe gjykata duke qenë se konform nenit 44 të LKA-së, ligjshmërinë e aktit administrativ të kontestuar e shqyrtohet brenda kufijve të kërkesës nga padia, ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vlerësimet faktike dhe juridike lidhur me pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Sa i përket vlerësimeve tjera tatimore, gjykata ka vendosur sikurse në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ngase të njëjtat tani më nuk janë kontestuese, kjo për faktin se përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në seancën e datës 14.03.2024 në precizimin e kërkesëpadisë ka propozuar që: *të mbete në fuqi vendimi nr.591/2019 i datës 13.02.2020, për shumën e caktuar si detyrim prej 8.330.15 €, tutje ka theksuar se : paditësi nuk e konteston shumën prej 8.330.15 €, përfshirë ndëshkimet si detyrim ndaj te paditurës, obligime këto të vlerësuara si të tilla edhe me super ekspertizën financiare të datës 05.02.2024, e të cilën ekspertizë këtu paditësi nuk e kundërshton, respektivisht gjetjet e të njëjtës i pranon pa vërejtje. Pra të njëjtat pala paditëse i ka bërë si jo kontestuese andaj edhe gjykata nuk është lëshuar më tej në elaborim dhe vlerësim të të njëjtave.*

Ligji Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative, Neni 46, paragrafi 1. *“Gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim”,* paragrafi 2. *“Me aktgjykim, padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar”.* Paragrafi 3. *“Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar”,* paragrafi 4. *“Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”,* dhe paragrafi 5. *“Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore “.*

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, par 1 dhe 46 par. 1, 2, 3, 4, dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.79/2022 datë 14.03.2024

Zyrtare Ligjore
Amire Jahiri

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate